


PËRDORIMI I WI-FI FALAS

A kanë fëmijët tuaj detyra shtëpie online? Gjatë krizës së koronavirus-it Telenet dhe Proximus i kanë hapur rrjetet e tyre për fëmijët që nuk kanë internet në shtëpi. Ndiqni këto hapa për përdorimin:

HAPI 1: SHIKONI NËSE PRANË JUSH KA NJË RRJET FALAS

Ju nuk mund të përdorni gjithandej wi-fi falas. Kjo është e mundur vetëm nëse fqinjët tuaj janë të abonuar tek Telenet/Proximus. Pra ju duhet të dini nëse ka wi-fi falas pranë jush. Këtë mund ta gjeni me anë të një laptop-i ose smartphone.

KONTROLLONI NGA NJË KOMPJUTER ME WINDOWS 10



Klikoni tek katrori djathtas poshtë ekranit.

Klikoni pastaj tek 'network' (rrjeti).

Tani do shikoni një listë të tërë me rrjete wi-fi. Çdo rrjet ka një emër. Shikoni mos ka një rrjet me emrin 'Telenet WiFree' ose 'Proximus Public Wi-Fi'.



A shikoni një rrjet me emrin 'Telenet WiFree'?

Atëhere shkoni tek hapi 2, tek faqja që fillon me TELENET.


A shikoni një rrjet me emrin 'Proximus Public Wi-Fi'?

Atëhere shkoni tek hapi 2, tek faqja që fillon me PROXIMUS.

Nuk shikoni asnjë rrjet me emrin 'Telenet WiFree' ose 'Proximus Public Wifi'?

Atëhere nuk mund të përfitoni nga kjo ofertë. Lajmëroni shkollën për këtë.

KONTROLLONI NGA NJË SMARTPHONE OSE TABLET



Kërkoni simbolin e wi-fi. Për këtë duhet të ulni pjesën e sipërme të celularit për poshtë.

Klikoni te simboli i wi-fi për ta aktivizuar.

Tani shikoni të gjithë rrjetet wi-fi në afërsinë tuaj. Çdo rrjet ka një emër. Shikoni nëse ka dhe një rrjet me emrin 'Telenet WiFree' ose 'Proximus Public Wifi'.

A shikon një rrjet me emrin 'Telenet WiFree'?

Shko atëhere tek hapi 2 që fillon me TELENET

A shikon një rrjet me emrin 'Proximus Public Wi-Fi'?

Shko atëhere tek hapi 2 i faqes që fillon me PROXIMUS


Nuk shikon asnjë rrjet me emrin 'Telenet WiFree' ose 'Proximus PublicWifi'?

Atëhere nuk mund të përfitoni nga kjo ofertë. Lajmëroni shkollën për këtë.

e-inclusiewerking Stad Gent – www.digitaal talent.be

Vertaling Nederlands- Albanees. Dit is de vertaling Albanees van "Inloggen op gratis wifi" en bevat identiek dezelfde informatie als de Nederlandse tekst. Deze vertaling mag enkel verspreid worden met de originele brontekst "Inloggen op gratis wifi".


NË NJË KOMPJUTER ME WINDOWS 10 BËHET KËSHTU:



Klikoni te katrori djathtas poshtë ekranit.

Klikoni pastaj te 'netwerk'.


Tani shikoni këtë →



KLIKONI TEK TELENET WIFREE

Që të lidheni me WiFree ju nevojitet një emër dhe një fjalëkalim. Këto do t'i merrni nga shkolla.

Plotësojini:



Gebruikersnaam (emri i përdorimit)

Wachtwoord (fjalëkalimi):

Laptopi juaj do të lidhet që tani automatikisht me rrjetin e Wi-Free.

NUK LIDHENI DOT?

Mund të ndodhë që lidhja mos jetë shumë e fortë. Ose që modem-i i komshiut tuaj të jetë i fikur.

KENI NEVOJË PËR NDIHMË?

Telefononi falas në numrin e kujdesit ndaj klientit të Telenet

0800/66 720


Mund të merrni në telefon nga e hëna deri të premten midis orës 9 dhe 16.



PROXIMUS

HAPI 2: LIDHENI KOMPJUTERIN ME PUBLIC WI-FI

NË NJË KOMPJUTER ME WINDOWS 10 BËHET KËSHITU:



Klikoni te katrori djathtas poshtë ekranit.

Klikoni pastaj te 'netwerk'.

Tani shikoni këtë →



KLIKONI TEK PROXIMUS PUBLIC WI-FI

Që të lidheni me Public Wi-Fi ju nevojitet një emër përdorimi dhe një fjalëkalim. Këto do t'i merrni nga shkolla.

Plotësojini:

Gebruikersnaam (emri i përdorimit):

Wachtwoord (fjalëkalimi):

Laptopi juaj do të lidhet që tani automatikisht me rrjetin e Public Wi-Fi.

NUK LIDHENI DOT?

Mund të ndodhë që lidhja mos jetë shumë e fortë. Ose që modem-i i komshiut tuaj të jetë i fikur.

KENI NEVOJË PËR NDIHMË?

Telefononi ndihmën ndaj klientit të Proximus
0800/22 800

